



**Prishtinë: 12.10.2012**

**Kodi i ZRRE-së: V\_481\_2012**

**Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_792\_05\_12**

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_792\_05\_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 05.06.2012.

**Në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2012 nxori këtë:**

### **VENDIM**

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin M. O. (shifra në KEK: DPR - 2001363), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_792\_05\_12 i datës 17.05.2012.

### **Arsyetim**

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 29.05.2007 kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se pasi që hapur kapaku i njehsorit elektrik dy urat e tensionit janë të larguara me çka në dy faza njehsori elektrik nuk bënë matjen e energjisë së shpenzuar, gjithashtu është bërë regjistrimi i të gjitha pajisjeve që posedon konsumatori.

Pas kësaj Departamenti i Faturimit në KEK me datë 06.06.2007 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR07HP03106 në vlerë prej 841.80€.

Me datë 21.04.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut, për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se me listë të lexuesit për legalizim të njehsorit kemi dal në teren për legalizim dhe kemi konstatuar se nuk pranohet që të bëhet pranimi teknik sepse furnizohet me kabull 5x2,5mm<sup>2</sup> e cila nuk lejohet, për furnizim duhet kabull 4x6mm 4x10mm<sup>2</sup>, 4x16mm, afati 7 ditë për rregullim dhe pas rregullimit konsumatori duhet te lajmërohet në KEK.

Pas ngarkesës së KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike në vlerë prej 841.80€, konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK. Departamenti për Konsumatorë në KEK ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit ku edhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.



Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 17.05.2012 ka nxjerr vendim duke **refuzuar pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthimit të humbjeve) DPR07HP03106 në vlerë prej 841.80€, si dhe të rikalkuloj faturën e rikthimit të humbjeve dhe të merr për bazë shpenzimin e energjisë elektrike të regjistruar për periudhat prej 02/2007 e deri 04.2007 dhe atij shpenzimi ta ngarkoi edhe për dy faza tjera të cilat nuk i kanë regjistruar në njehsorin elektrik.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së me datë 05.06.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr. **ZRRE/DMK\_V\_792\_05\_12** të datës 17.05.2012. Në ankesën e KEK thuhet se sipas listave të lexuesit të KEK-ut është konstatuar se njehsori elektrik ka qenë pa bllob dhe se fatura ka rrjedh si rezultat i leximi e jo nga procesi i kontrollës dhe se kalkulimi i faturës është si rikthimi i humbjeve e jo si shpenzim i një faze. Në ankesë po ashtu është propozuar që të aprovohet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 tetor 2012 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit që fatura e rikthimit të humbjeve të mbetet në fuqi e jo të bëhet kalkulimi vetëm për dy muaj ashtu siç ka theksuar DMK/ZRRE.

Bordi ka analizuar Aktvendimin nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, Drejtorati i Inspeksionit, Sektori i Inspeksionit të Ndërtimtarisë nr. 354-17404 i datës 18.09.2006. Në këtë aktvendim të lëshuar nga Komuna theksohet se urdhërohet Mentor Hasani të pezullojë punën në objektin e lokalizuar në Prishtinë, rruga e Çagllavicës, si dhe Obligohet konsumatori të parashtojë menjëherë kërkesën për kushte urbanistike – leje ndërtimi.

Bordi gjatë analizës së faturave të rikthimit të humbjeve procesverbaleve të KEK-ut ka vërejtur se KEK-u e ka faturuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar me faturën DPR07HP02062 të datës 03.02.2007 në vlerë 8.87€ si rezultat i listës së leximit të punëtorit të KEK dhe se sipas kësaj fature KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me shpenzim 142 kWh për një muaj, si dhe ka hapur shifrën IL DPR – 2001363.

Është analizuar edhe fatura e rikthimit të humbjeve DPR07HP03106 e datës 06.06.2007 të përpiluar nga departamenti i faturimit në KEK, dhe se gjatë analizës është konstatuar se KEK-u ka gabuar në llogaritjen e faturës së rikthimit të humbjeve, ngase për fatura mujore ka përdorur dy vlera të ndryshme, njërën në vlerë prej 52.36 € dhe tjetrën në vlerë prej 61.00€. Sipas transaksioneve të konsumatorit të shifrës DPR – 2001363 vërehet se kjo shifër është regjistruar me datë 03.02.2007 me anë të faturës së rikthimit të humbjes dhe se pas kësaj ka pasur fatura konsumatori për muajin 02/2007, 03/2007 dhe 04/2007 para se të faturohet prapë me rikthim të humbjeve me datë 06.06.2007 duke u kthyer mbrapa për 12 muaj. Duhet theksuar se sipas listave të leximit të KEK-ut vërehet se lexuesi i KEK-ut në muajin 02, 03 dhe 04/2007 ka evidentuar se njehsori elektrik nr. 43681204 nevojitet kontroll dhe se i mungon vula distributive.

Bordi ka vërejtur se në momentin e daljes se ekipeve të inspektimit dhe kontrollës nga ana e KEK-ut, është konstatuar se konsumatori ka qenë shfrytëzues ilegal i energjisë elektrike, si dhe njehsori që ka qenë duke regjistruar energji ka pas dy urat e tensionit të larguara dhe nuk ka bërë matjen e energjisë në këto dy ura. Konsiderojmë se KEK-u, në momentin e daljes dhe konstatimit të gjendjes ka pas për obligim që të veprojnë konform nenit 9 paragrafi 9.3, pika a) dhe c) të Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Sipas nenit 9 paragrafi 9.3, përkatësisht pika a) të Procedurës për identifikimin dhe shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike theksohet se ekipet e inspektimit në rastet e konstatimit të shfrytëzimit të



paautorizuar të energjisë elektrike duhet të veprojnë në këtë mënyrë, *shkyç furnizimin me energji elektrike, largon njehsorin elektrik në të cilin janë konstatuar gjurmë të abuzimit dhe të njëjtin e dërgon në laboratorin e kalibrimit*; Pika c) vendos tjetër njehsor në afatin jo më vonë se 24 orë nga koha e largimit të njehsorit sipas pikës (a), në objektin në të cilin është ndërprerë furnizimi me energji elektrike.

Gjithashtu neni 5 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 i Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji përcakton se Operatori i sistemit duhet të sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve elektrik, andaj KEK-u në këtë rast nuk ka vepruar konform këtyre rregullave, në mënyrë që të shmang këtë parregullsi në njehsor, duke pasur parasysh se nga vet punëtorët e KEK-ut është konstatuar se kemi dëmtim të njehsorit elektrik.

Sipas analizës së shpenzimit të energjisë elektrike vërehet se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike nga inspektimi i datës 29.05.2007 e tutje ka një ngritje graduale të shpenzimit të energjisë elektrike dhe kjo vërehet nga shpenzimi sipas viteve. Po ashtu janë analizuar edhe listat e leximit të KEK-ut dhe se sipas listave të leximit për periudhën kohore 03, 04, 05/2007 është evidentuar se njehsorit elektrik i mungon blloba dhe duhet t'i bëhet kontroll njehsorit elektrik, ndërsa për periudhën kohore 06 dhe 09/2007 lexuesi ka evidentuar se mungon blloba, por njehsori elektrik është në rregull.

Bordi thekson se për të llogaritur më saktë faturën e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike duhet të bëhet rillogaritja e faturës se rikthimit të humbjeve e cila do të llogaritet vetëm për 3 muaj dhe të merren për bazë parametrat e shpenzuar të energjisë së faturuar në atë periudhë dhe t'i shtohen edhe 2/3 e energjisë për këtë periudhë ku për këtë pjesë duhet të obligohet konsumatori të paguaj energjinë shpenzuar.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu ankesa e KEK-ut, nuk i përmban elementet bazë të një ankese pasi që është shumë e mangët për kah përmbajtja. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirr në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_792\_05\_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar